

raport vjetor

2007

GRUPI UNION SHKK

Është bashkimi vullnetar i Shoqërive Kursim Kredi (SHKK), i krijuar më 25 Janar 2002 mbi bazën e ligjit për Shoqëritë Kursim Kredi dhe i licensuar nga Banka e Shqipërisë.

I inspiruar nga modelet e kooperativës financiare, Unioni dhe Shoqëritë Kursim Kredi kanë rrënjë të forta sociale në komunitetet lokale. Klientët e Unionit SHKK janë banorë të zonave rurale të cilët njëkohësisht janë edhe anëtarë të Shoqërive Kursim Kredi.

MISIONI i Grupit Unioni SHKK është t'u ofrojë shërbime financiare anëtarëve të Shoqërive Kursim Kredi në fshat, me qëllim nxitjen e aktiviteteve prodhuese, përmirësimin e nivelit të jetesës dhe zhvillimin e vazhdueshëm të zonës rurale.



Të dashur anëtarë,
Të dashur lexues,

Grupi Union SHKK gjatë vitit 2007 arriti të gjitha objektivat e përcaktuara në strategjinë e tij të zhvillimit, strategji që ndër të tjera synon forcimin e pozicionit tonë si ofrues thujtë ekskluzivë të shërbimeve të mikrofinancës në zonën rurale.

Duke vazhduar të konsolidojë identitetin e vet, të shprehur në bashkëpunimin e ndërsjellë dhe drejtimin demokratik me 720 të zgjedhur dhe 20457 anëtarë, në fund të vitit 2007 Grupi vepron në 13 rrethe dhe 698 fshatra, të organizuar në 101 SHKK.

Kjo shtrirje e aktivitetit me një portofol kredie 3,1 miliardë lekë, portofol depozite 823 milionë lekë dhe cilësi të lartë të portofolit (PAR 0.5%), u vlerësua nga platforma globale e mikrofinancës MIX, duke e klasifikuar Unionin si një ndër 15 institucionet më të mira të mikrofinancës në botë për vitin 2007.

Si faktorë kryesorë të suksesit, ne konsiderojmë kombinimin racional të performancave financiare me ato sociale të institucionit, dinamizmin dhe kapacitetet gjithnjë në rritje të shoqërive kursim-kredi, përvojën e akumuluar në vite, si dhe përkushtimin e të zgjedhurve e punonjësve tanë, që kanë kontribuar ndjeshëm për krijimin e emrit të mirë të Unionit në vite, si partner i besueshëm i fermerëve në zonën rurale.

Grupi Union – SHKK, edhe në të ardhmen, është i gatshëm t'u përgjigjet dhe të përmbushë nevojat financiare në rritje të fermerëve, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e nivelit të jetesës e zhvillimin e vazhdueshëm të zonës rurale, por edhe në forcimin e lidhjeve shoqërore e frymës demokratike brenda komunitetit.

Zana KONINI
Kryetare e Bordit të Drejtorëve



Organet drejtuese të shoqërive kursim kredi dhe Unioneve të tyre, janë Asambleja e Përgjithshme, Bordi drejtues dhe Komiteti mbikëqyrës

Bordi drejtues

Zana Konini	Kryetar
Lutfi Lala	Nënkryetar
Afrim Azuni	Anëtar
Qemal Lashi	Anëtar
Kristaq Dhima	Anëtar
Ahmet Dema	Anëtar
Donika Stasa	Anëtar

Komiteti Mbikqyrës


Hasan Shehu	Kryetar
Mina Sulanjaku	Nënkryetar
Fatosh Danaj	Anëtar
Estref Cekrezi	Anëtar
Astrit Caca	Anëtar



ANËTARET, KLIENTËT DHE TË ZGJEDHURIT TANË

- Ndër 20,457 individë të anëtarësuar në SHKK-të, 14,260 janë klientë aktivë për vitin 2007.
- Aktiviteti ynë financiar është i pranishëm në 698 fshatra, të organizuara në 101 SHKK, në 13 rrethe të vendit.
- 650 janë të zgjedhurit në SHKK, që me përkushtimin dhe profesionalizmin e tyre garantojnë jetëgjatësinë e sistemit.


Vitet	2003	2004	2005	2006	2007
Klientë Aktivë	7,621	7,157	8,650	10,655	14,209
Anëtarë	8,161	10,584	12,815	16,260	20,457



AKTIVITETI I KREDIDHËNIES

- ◆ Aktiviteti kryesor i GRUPIT UNION SHKK është ai i kredidhënies për anëtarët e rrjetit. Teprica e kredisë është 3,111,318,733 lekë sipas 31.12.2007.
- ◆ Teprica e kredisë është rritur 30% në krahasim me vitin 2006, duke mbajtur një cilësi të lartë të portofolit.
- ◆ Portofoli i kredisë zë pjesën më të madhe të aseteve të GRUPIT UNION SHKK. **87.3%** e totalit të aseteve të GRUPIT përbëhet nga portofoli i kredisë.

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007
Portofoli i kredisë (në lekë)	894,273,095	1,227,367,020	1,619,597,893	2,396,063,247	3,111,318,733
Portofoli në risk (në %)	0.85	0.65	0.55	0.47	0.5






AKTIVITETI I DEPOZITAVE

Depozita është një shërbim tjetër financiar që ofrohet nga Unioni SHKK.

Aktualisht, Unioni SHKK ofron për anëtarët e rrjetit depozita me afat (3, 6, 12, 24, 36 mujor) dhe depozita për fëmijë.

- Portofoli i Depozitave është 823,865,340 lekë, në 31.12.2007.
- Volumi i depozitave është rritur me 73% krahasuar me 2006.

Vitet	2003	2004	2005	2006	2007
Depozitat (në milion lekë)	35.5	103.8	206.7	475.7	823.8




STRUKTURA E FINANCIIMIT TË KREDISË NË RRJETIN SHKK

Tre janë burimet kryesore të financimit të kredisë në SHKK: Kapitali, Depozitat nga klientët, dhe Rifinancimet që jep Unioni SHKK.


Nga viti në vit, në rrjetin SHKK po zvogëlohet përqindja që zënë Rifinancimet në financimin e kredisë, dhe po rritet përqindja që zënë burimet e brendshme të financimit si Depozitat nga klientët dhe Kapitali.

Vitet	2005	2006	2007
Rifinancimet/Portofol Kredie	72.3%	68.0%	62.1%
Depozitat/Portofol Kredie	12.8%	19.4%	24.5%
Kapitali/Portofol Kredie	14.9%	12.6%	13.4%

Struktura e financimit të kredisë në rrjetin SHKK



Kapitali i GRUPIT UNION SHKK



Vitet	2004	2005	2006	2007
Kapitali i rrjetit SHKK (në milion lekë)	168.2	242.7	298.0	416.9
Kapitali i Unionit (në milion lekë)	546.2	670.7	668.1	740.3
Kapitali i GRUPIT UNION SHKK (në milion lekë)	714.4	913.4	923.3	1,100.0



PASQYRAT FINANCIARE

1. Bilanci i GRUPIT UNION-SHKK

AKTIVE	dt. 31.12.2007	dt. 31.12.2006
Banke, Arkerke	25,332	86,515
Investime	393,696	142,021
Portofoli Kredise	3,099,597	2,386,078
Aktive fikse neto	28,515	18,031
Aktive te tjera	18,369	16,070
Totali I aktiveve	3,565,509	2,648,715
DETYRIMET		
Hua (linja kredie)	1,482,484	1,076,724
Depozita	823,865	475,707
Detyrime te tjera	165,744	171,544
Total I detyrimeve	2,472,093	1,723,975
KAPITALE		
Kapitale	792,167	739,326
Rezerva	301,249	185,414
Total kapitale	1,093,416	924,740
Total detyrime dhe kapitale	3,565,509	2,648,715

2. Rezultati i GRUPIT UNION-SHKK

	dt. 31.12.2007	dt. 31.12.2006
Te ardhura nga interesat	406,581	308,164
Pagesa interesi	(91,012)	(72,884)
Te ardhura neto nga interesat	315,569	235,280
Te ardhura te tjera	52,865	37,826
Shpenzime te tjera	(29,788)	(29,357)
Te ardhura neto te tjera	23,077	8,469
Provigjone per kredi	(2,217)	(1,027)
Amortizimi i aktive fikse	(6,777)	(5,500)
Shpenzime personeli	(82,461)	(69,407)
Shpenzime administrative	(131,359)	(92,288)
Total shpenzime	(222,814)	(168,222)
E ardhura neto	115,832	75,527

Shënim: në 000 lekë

3. Bilanci kontabël i UNIONIT SHQIPTAR KURSIM KREDI

AKTIVE	dt. 31.12.2007	dt. 31.12.2006
Arkë dhe Bankë	12,810	61,280
Investime afatshkurtra	384,923	133,819
Totali i portofolit të kredisë	2,010,485	1,643,061
Aktive Fikse	25,214	15,892
Të tjera aktive afatshkurtra	19,890	13,867
Total aktivi	2,453,322	1,867,919
DETYRIMET		
Hua (Linja kredie)	1,482,484	1,076,724
Detyrime kundrejt klienteve (Depozita)	164,084	31,526
Të tjera detyrime	66,435	90,134
Total detyrime	1,713,003	1,198,384
KAPITALE		
Kapitale	603,695	585,994
Rezerva per risqe	136,624	83,541
Total kapitale	740,319	669,535
Total kapitale dhe detyrime	2,453,322	1,867,919

4. Rezultati i UNIONIT SHQIPTAR KURSIM KREDI

	dt. 31.12.2007	dt. 31.12.2006
Te ardhura nga interesat e kredive	233,850	200,842
Pagesa per interesa	(47,773)	(41,362)
Te ardhura neto nga interesat	186,077	159,480
Te ardhura te tjera	43,630	31,589
Shpenzime te tjera	(15,478)	(13,661)
Te ardhura te tjera neto	28,152	17,928
Provizjone per kredi te rrezikuara	588	904
Amortizimi i aktiveve fikse	(6,272)	(5,053)
Shpenzime personeli	(79,274)	(66,006)
Shpenzime administrative	(76,188)	(63,316)
Total shpenzime	(161,146)	(133,471)
Rezultati neto	53,083	43,937

Shënim: në 000 lekë



5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë në UNIONIN SHQIPTAR KURSIM KREDI

Cash Flow nga aktiviteti operacional	dt. 31.12.2007	dt. 31.12.2006
Rezultati I vitit	53,083	43,937
Axhustimi per te perftuar cash-in neto		
- Amortizimi	6,272	5,053
- Provigjone	6,771	7,941
- Te ardhura te perlllogaritura	(12,916)	(14,216)
- Shpenzime te perlllogaritura	39,159	13,704
- Amortizimi granteve	(27,054)	(22,947)
Cash-I neto I perdorur	65,315	33,472
Ndryshimet ne aktivet dhe detyrimet operaconale		
(Rritja)/Ulja e kredive per anetar	(366,836)	(438,300)
Rritja/(Ulja) e depozitave per anetar	130,452	16,541
(Rritja)/Ulja aktiveve te tjera	(6,023)	13,000
Rritja/(Ulja) e pasiveve te tjera	(23,700)	(26,803)
Cash-I neto I perdorur ne aktivitetin operacional	(266,107)	(435,562)
Cash Flow nga aktiviteti I investimeve		
Ulja /(Rritja) e depozitave me afat	(244,855)	90,051
Ulja /(Rritja) e bonove te thesarit		436,974
Blerje aseteteve fikse	(15,593)	(13,074)
Cash-I neto I perdorur ne aktivitetin e investimeve	(260,448)	513,951
Cash Flow nga aktiviteti I financimeve		
Ndryshime ne Huate afat gjata te marra	395,068	(110,184)
Ndryshime ne grantet te marra		0
Ndryshime ne kapitale dhe rezerva	17,702	15,620
Cashi neto nga aktiviteti I financimeve	412,770	(94,564)
Ulja/Rritja e cash-it	(48,470)	17,297
Cash ne fillim te periudhes	61,280	43,983
Cashi ne fund te periudhes	12,810	61,280

PARTNERËT TANË



Kooperacioni Spanjoll – Unioni SHKK ka marrë dy linja kredie me AECI (Agjencia Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar). Këto dy linja kredie janë akorduar nëpërmjet nënshkrimit të 2 marrëveshjeve të huasë midis Unionit dhe Kooperacionit Spanjoll në Shkurt 2005 dhe Shkurt 2007

◆ Nënshkrimi i marrëveshjes me Kooperacionin Spanjoll



RABOBANK - Me Rabobank vazhdon bashkëpunimi në kuadrin e projektit për forcimin e kapaciteteve teknike në Union dhe rrjetin SHKK. Në këtë kuadër, u krye edhe një vizitë studimi në Rabobank, Hollandë nga një ekip përfaqësues i Unionit në Nëntor 2007.

◆ Vizite ne Rabobank



Credit Mutuel - Me Credit Mutuel, Unioni vazhdon të ruajë një marrëdhënie afatgjatë në kuadrin e shkëmbimit të asistencës dhe ekspertizës teknike. Vizita më e fundit në Union është bërë nga një ekip i Credit Mutuel në Janar 2008.

◆ Vizite nga ekipi i Credit Mutuel



NGJARJE DHE AKTIVITETE

PERVJETORI I 5-TE I KRIJIMIT TE UNIONIT SHKK

Në janar 2007, Unioni SHKK festoi 5-vjetorin e krijimit të institucionit. Në këto 5 vjet, Unioni SHKK ka konsoliduar identitetin e vet duke kombinuar performancat financiare me ato sociale, biznesin me demokracinë, profesionalizmin e stafit me dinamizmin e të zgjedhurve në zonën rurale. Unioni SHKK është institucioni mikrofinanciar që i ka shërbyer denjësisht banorëve të zonave rurale, të cilët praktikisht janë të përjashtuar nga perfitimi i shërbimeve financiare nga sistemi tradicional bankar. Në tërë këta vjet, Unioni SHKK ka krijuar një profil pozitiv në shërbimin ndaj klientelës rurale dhe kapërcimin e sfidave që ekzistojnë në mikrofinancën rurale në Shqipëri.

ASAMBLETË VJETORE TË SHKK-VE DHE ATO RAJONALE

Në bazë të Ligjit “Për Shoqëritë e Kursim Kreditit” dhe Statutit të SHKK-ve, në muajt Janar - Shkurt 2007 u zhvilluan **Asambletë e Përgjithshme Vjetore** të SHKK-ve. Në Asambletë e Përgjithshme që bëhen cdo vit, kryhet analiza e punës një vjecare dhe miratohen llogaritë e SHKK-ve, strategjitë dhe buxheti për vitin 2007.

Gjatë muajit Mars u zhvilluan edhe Asambletë Rajonale, të cilat i paraprinë zhvillimit të Asamblesë së Përgjithshme Vjetore të Unionit. Këto Asamble vlerësohen vecanërisht për mundësinë e shkëmbimit të eksperiencës dhe problematikës midis SHKK-ve në rrethe të ndryshme.

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E UNIONIT

Asambleja e Përgjithshme e Unionit është organi më i lartë i vendimarrjes. Asambleja e Përgjithshme e Unionit zhvillohet cdo vit pas mbarimit të Asambleve të Përgjithshme të SHKK-ve dhe ato Rajonale.

Asambleja e Zakonshme Vjetore e Unionit u zhvillua më 21 Prill 2007 me pjesëmarrjen e të gjitha SHKK-ve të rrjetit. Asambleja aprovoi vendime të rëndësishme dhe vlerësoi pozitivisht ecurinë e GRUPIT UNION SHKK për vitin paraardhës.



5 vjetori i Unionit

Asamble e Përgjithshme e SHKK Tregan-Elbasan



Asamblete Rajonale Dhjetor 2007



Asambleja e Përgjithshme e Unionit



Asambleja e Përgjithshme e Unionit



IMAZHI INSTITUCIONAL

Zyra të reja të SHKK-ve



ShKK Mizë - Lushnje



ShKK Allkaj - Lushnje



ShKK Tregan - Elbasan



SHKK Himarë - Vlorë




SHKK Drini2 - Bushat, Shkodër



ShKK Gracen - Elbasan

Prania e Unionit SHKK në median e shkruar





UNIONI SHKK NË 15 INSTITUCIONET MË TË MIRA NË BOTË

MIX-i (Microfinance Information eXchange) një nga platformat dhe rjetet me te medha te mikrofinances ne mbare boten, e renditi **Union SHKK ne 15 institucionet me te mira ne bote**. Pevce informimit dhe shkëmbimit të informacionit, MIX-i kryen rregullisht analiza dhe klasifikime të institucioneve nga e gjithë bota bazuar në metodologji shkencore dhe sipas disa katerëve të caktuara.

Raporti më i fundit i nxjerrë nga MIX-i, ka studiuar 820 institucione mikrofinanciare në botë nga të cilat ka nxjerrë 100 më të mirat sipas 4 kriterëve kryesore: Efektiviteti në kosto, Madhësia e aktivitetit (outreach-i), Eficenca, dhe Transparenca. Në vlerësimin me përqindje, Unioni SHKK ka marrë një vlerësim prej 62.9% për outreach-in, 71.4% për efencën dhe 100% për transparencën, dhe mesatarisht është vlerësuar me 78.1%.

Në 15 vendet që kryesojnë këtë top listë, nga Shqipëria është vetëm një institucion mikrofinanciar – **Unioni SHKK**.

Ky është një vlerësim shumë pozitiv për institucionin tone pasi jemi i vetmi institucion shqiptar që ka marrë këtë klasifikim shumë të lartë duke marrë parasysh që vlerësimi është bërë në rang botëror.



Table 1: MIX Global 100: Composite (Top 25)

Rank	MFI Name	Country	Overall Percentage	Outreach Percentage	Efficiency Percentage	Transparency Percentage
1	Ukash	Kenya	84.2%	81.1%	86.9%	100%
2	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
3	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
4	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
5	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
6	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
7	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
8	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
9	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
10	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
11	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
12	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
13	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
14	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
15	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
16	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
17	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
18	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
19	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
20	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
21	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
22	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
23	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
24	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%
25	Ukash	Kenya	83.8%	81.1%	86.9%	100%

Source: MIX Global 100 Ranking as of November 1, 2007. All rankings are in the order of the report.

Microfinance Information eXchange, Inc. 1901 Pennsylvania Avenue, Suite 207, Washington, DC 20006, USA
Tel: +1 202 224 9100 Fax: +1 202 224 9101



RAPORTI I AUDITIT TË JASHTËM PËR VITIN 2007

